



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 12, Datë 10.01.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“M.T.C ENERGY” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG TË ASETETE TË LUAJTSHME  
DHE VENDOSJES SË HIPOTEKËS PËR ASETET E PALUAJTSHME TË  
ARDHSHME APO TË TASHME, NË FAVOR TË RAFFEISEN BANK SH.A, PËR  
EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË SË DHËNË.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika “1”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” gjithashtu dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit në lidhje me kërkesën e shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe vendosje të hipotekës mbi asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, në favor të Raiffeisen Bank sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e datës 22.12.2017, protokolluar në ERE me nr. 817/2 Prot, datë 28.12.2017, shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k., ka kërkuar miratimin e ERE në lidhje me kërkesën e saj për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, për garantimin e detyrimeve të kredisë.
- Shoqëria "M.T.C Energy" sh.p.k. ka marrë dy kredi pranë Raiffeisen Bank sh.a., marrëveshje e nënshkruar në vitin 2012 dhe së fundmi me Kontratë Kredi bankare nr.4087 rep, nr.2475 kol, datë 07.11.2016 me qëllim për të financuar investimin për ndërtimin e Hidrocentralit Radovë.
- Për garantimin e detyrimeve të kredisë, Shoqëria ka vendosur si garanci në favor të Raiffeisen Bank. sh.a., asetet e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë sipas kontratave dhe i drejtohet ERE-s me kërkesën për miratimin e lënies peng të aseteve të luajtshme dhe vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, për garantimin e detyrimeve të kredisë.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në *Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit* si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 7 pika 1 gërma “j”, (nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt).
- Nenin 7 pika 3. (Subjektet konçencionare të licensuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konçensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi.), do të njoftohet subjekti që që në bazë të nenit 10 pika 2 të *Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit*, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për lënien peng të asetëve të luajtshme dhe vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme të shoqërisë, në favor të Raffeisen Bank sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**